



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DREJTORIA E METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT

PROGRAM TRAJNIMI

Muaji Shtator 2021

Referuar Plan-Veprimit mbi zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të Audituesve të KLSH-së” për vitin 2021, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 14 datë 08.02.2021, gjatë muajit Shtator 2021, **u zhvilluan trajnimet sipas Programit të mëposhtëm, ku morën pjesë 109 auditues.**

Fokusi i trajnimit: “Trajnim mbi tema specifike sipas nevojave të departamenteve dhe prezantim i praktikave më të mira”

Nr.	Temat	Trajnuesit
1.	Trajnim mbi Tema specifike sipas natyrës dhe nevojave të vetë departamenteve Do të trajtohen, kryesisht tematika me inters në bazë të natyrës së vecantë të secilit departament në KLSH dhe problematikave të dala gjatë auditimeve mbi çështje specifike.	- Klarenc Xhaferraj - Lolita Baholli - Albert Thoma - Orges Levani - Jorida Zhegu - Rodjan Alimerkaj - Aulent Guri
2.	Prezantimi i praktikave më të mira, (auditime të zhvilluara gjatë vitit 2020 dhe 6-mujori i I-rë, 2021) Do të prezantohen auditimet më të arrira në bazë të zbatimit të standardeve të auditimit, Manualeve të Auditimit dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit, gjatë realizimit të Projektit të Auditimit.	- Rigles Guzi dhe Helena Solis - Valentina Golemi - Kristaq Gjurgjaj - Luan Kuka - Jonild Hoxhaj - Kozma Kondakciu dhe Benard Haka - Miranda Berdo

Target grupi: Trajnimi do të organizohet, sipas departamenteve i ndarë në dy për secilin në total 14 ditë.

Kalendari i realizimit të trajnimeve:

Muaji Korrik, 2021

E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte	E shtunë	E dielë
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26

27	28	29	30		
----	----	----	----	--	--

- Nga data 3-7 Shtator, përgatitja e Programit të trajnimeve;
- Nga data 8-10 Shtator, përgatitja e temave nga trajnuesit;
- Nga data 13-30 Shtator, zhvillimi i trajnimeve.

- **Kohëzgjatja e trajnimit:** Trajnimi do të zgjasë 1.30 orë.

Nr.	Departamentet e Auditimit në KLSH	Temat	Trajnerët	Datat
1	Auditimit të Buxhetit të Shtetit	1. Auditimet më të mira Prezantimin e auditimit te kryer ne MFE per zbatimin e Buxhetit Faktik	Rigelsi Gjuzi Helena Solis	13.09.2021
		2. Sipas nevojave specifike Legjislacioni fiskal dhe procedurat tatimore	Klarenc Xhaferraj	14.09.2021
2	Auditimit të Institucioneve Qendrore	1. Auditimet më të mira Drejtoria Burgjeve	Valentina Golemi	15.09.2021
		2. Sipas nevojave specifike Prezantim i ligjit mbi Prokurimin Publik	Lolita Baholli	16.09.2021
3	Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore	1. Auditimet më të mira Bashkia Finiq	Kristaq Gjurgjaj	17.09.2021
		2. Sipas nevojave specifike Mbi auditimin e Njesive te Veteqeverisjes Vendore	Albert Thoma	20.09.2021
4	Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	1. Auditimet më të mira Auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Rrugëve Veri, zhvilluar në vitin 2020 dhe evaduar në vitin 2021	Luan Kuka	21.09.2021
		2. Sipas nevojave specifike Ndryshimet e legjislacionit në lidhje me pronat në dy vitet e fundit dhe efekti që japin në auditimet e Departamentit (përshtatja e programeve të auditimit me këto ndryshime -	Orges Levani	22.09.2021

5	Auditimit të Shoqërive Publike dhe investimeve të huaja	1. Auditimet më të mira Porti Detar Vlorë	Jonild Hoxhaj	23.09.2021
		2. Sipas nevojave specifike Prezantim mbi hierarkinë e standarteve të auditimit	Jorida Zhegu	24.09.2021
6	Auditimit IT	1. Auditimet më të mira Auditimi i Performancës “Efektiviteti i procesit të qendërimit të ofrimit të shërbimeve nga AKSHI për periudhën 2017-2020	Kozma Kondakciu Benard Haka	27.09.2021
		2. Sipas nevojave specifike "Siguria Kibernetike"-	Rodjan Alimerkaj	28.09.2021
7	Auditimit të Performancës	1. Auditimet më të mira Efektiviteti i shërbimit të Institucioneve të Ekzekutimit të Veprave Penale	Miranda Berdo	29.09.2021
		Sipas nevojave specifike; Perdorimi i standardeve ISSAI 5510 dhe 5520 ne auditimet e performances ne ceshtje qe lidhen me katastrofat natyrore -	Aulent Guri	30.09.2021

Elementët e trajnimit:

- **Skedulimi**
- **Zhvillimi**
- **Kontroli**
- **Vlerësimi**

Që të realizohet një proces trajnimi optimal, duhet të plotësojmë disa kushte:

- Sigurimi i teknikës së nevojshme: Trajnimi do të zhvillohet online, nëpërmjet Platformës “Microsoft Skype”. Trajnerët para orës së trajnimit duhet të dërgojnë me email, të gjithë audituesve të përcaktuar për të ndjekur trajnimin, linkun ku do të aksesojnë;
- Sigurimi i materialeve të nevojshme: Të gjithë audituesit, kanë akses të plotë mbi materialet të cilat do të jenë objekt i këtij trajnimi. Standardet, rregulloret, udhëzues, ligji organik i KLSH-së etj., si dhe Raportet e Auditimit, janë të publikuara në faqen web të KLSH-së.
- Sigurimi i trajnerëve të aftë: Nga lista e trajnerëve janë përzgjedhur trajnerë, të cilët kanë kompetencën e duhur profesionale në drejtimet përkatëse të trajnimit.

Skedulimi i programit: Skedulimi i programit është bërë duke patur në konsideratë ngarkesën në punë të audituesve, Zhvillimi online është një lehtësi, pasi ndjekja e trajnimit mund të kryhet nga vendet e punës, pa prezencë fizike. Është shtrirë në 2 ditë, me fokus nevojat specifike të departamenteve, si dhe prezantimi i një ose dy auditimeve më të mira në nivel departamenti. Trajnimi do të jetë dy orë në ditë, duke mos cenuar veprimtarinë audituese të gjithsecilit.

Zhvillimi i trajnimit: Zhvillimi i trajnimit, është konkretizimi i të gjitha etapave të mëparshme të procesit të trajnimit si; përcaktimi i nevojave, planifikim-programimi dhe skedulimi.

Në etapën e zhvillimit të trajnimit ndikojnë disa faktorë:

- Përzgjedhja e platformave të ndryshme on-line;
- Përgatitja e lektorëve, sa ata e bëjnë tërheqës trajnimin;
- Përgatitja dhe interesi i pjesëmarrësve, sa ata kanë interes rreth çështjeve që trajtohen, kjo është e lidhur ngushtë me etapën e parë të këtij procesi me përcaktimin e nevojave dhe sa janë të përgatitur pjesëmarrësit.

Kontrolli: Gjatë procesit të zhvillimit të trajnimit është e rëndësishme që në mënyrë permanente të ndiqet sa është realizuar dhe si janë realizuar objektivat që janë programuar për t'u realizuar. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet disa mënyrave:

- Testimi i reagimit të pjesëmarrësve gjatë zhvillimit të trajnimit, kjo nuk teston njohuritë e tyre, por mund të vlerësojë pozitivisht interesin e tyre, për çështje të veçanta dhe vlerësimin për trajnerë të veçantë;
- Testimi i njohurive, në fund të zhvillimit të seancave për çështje të caktuara;
- Shembuj konkretë duke punuar në grupe të vogla, vlerësimi i tyre;
- Debateve dhe konkluzioneve në fund të çdo seance, etj.

Vlerësimi i trajnimit: Vlerësimi i trajnimit është etapë me rëndësi, pasi mbledh të dhënat e nevojshme për të përcaktuar nëse procesi i trajnimit ishte i efektshëm.

Vlerësimi i programi i trajnimit: *(Plotësimi i pyetësorit të përgatitur nga trajnuesit, nga ana e audituesve, pjesëmarrës në trajnim)*

- Për të përcaktuar nëse trajnimi ka kontribuar në arritjen e qëllimeve të auditimit;
- Për të vlerësuar si dhe sa, të trajnuarit perfeksionuan njohuritë e tyre në këtë proces trajnimi;
- Për të vlerësuar metodat e përdorura në trajnim, nëse ato e ndihmuan të trajnuarin në arritjen e objektivave të trajnimit.
- Për të dizajnuar sa më mirë trajnimin e ardhshëm duke vlerësuar se ku ishin të metat dhe dobësitë e trajnimit të kryer.
- Për ta bërë në këtë mënyrë trajnimin një mjet sa më efikas
- Për të justifikuar koston e trajnimit, pasi KLSH investon në mënyrë që të përfitohen avantazhet e programuara.

Drejtore

Brunilda Zeneli